

A 3D architectural rendering of a modern university building. The building features a mix of materials: white walls, dark grey panels, and red brickwork. Large glass windows reflect the surrounding environment. In the foreground, there is a paved courtyard with a circular stone-patterned area and several young trees. The sky is clear and blue.

**PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË
UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"**

2016-2020

PËRMBAJTJA E LËNDËS

• HYRJE	3
• PALËT E INTERESIT	4
• PROCESI I PLANIFIKIMIT	6
• MISIONI	8
• VIZIONI	10
• ANALIZA E GJENDJES SË DERITANISHME	12
• <i>Rezultatet</i>	14
• OBJEKTIVAT	18
• HARTA STRATEGJIKE	19
• EDUKIMI	20
• KËRKIMI SHKENCOR	25

SHKURTESA

UNIKO – Universiteti i Korçës

FB- Fakulteti i Bujqësisë

EDE- Ekonomia Didaktike Eksperimentale

FEF- Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

FE- Fakulteti i Ekonomisë

FSHNNH- Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane

A- Fusha strategjike e Edukimit

B- Fusha strategjike e Kërkimit Shkencor

Për të arritur objektivat e tij, Universiteti i Korçës (UNIKO) ka hartuar një Plan Strategjik zhvillimi, i cili duhet të shndërrohet në vullnet të përbashkët: ai duhet të përfshijë të gjithë anëtarët e komunitetit universitar; e gjithë bashkësia duhet të bëhet pjesë e zbatimit të tij, duke pranuar se stafi mësimor, ai ndihmësmësimor e administrativ, si dhe studentët, janë të përkushtuar për të shpalosur mundësitë e tyre në auditorë, në laboratorë e në bibliotekë, në shkollat apo institucionet e rajonit, si dhe në konferenca e veprimtari të tjera shkencore.

Kjo përfshirje duhet të nxitet nga organet drejtuese të Universitetit, Dekanët, Përgjegjësit e Departamenteve, Përgjegjësit e grupeve mësimore-kërkimore, si dhe të gjithë aktorët e përfshirë në menaxhimin e strukturave universitare. Ata janë zbatuesit e parë dhe garantuesit e politikave dhe strategjive të Universitetit.

Një pjesëmarje kaq e gjerë kërkon, gjithashtu, një ndjenjë të fortë identiteti, të ushqyer jo vetëm me ndarjen e objektivave, por, mbi të gjitha, me vëmendjen e veçantë kushtuar individëve dhe aspiratave të tyre profesionale: potencialit të tyre për zhvillim, vlerësimin të drejtë të meritës në karrierë dhe njohjes së kontributit dhe përvojës që ata lënë.





PALETË E INTERESIT




UNIKO përballet me dy aktorë kryesorë: studentët dhe shoqërinë. Detyra kryesore e Universitetit është të përcjellë dije, duke përgatitur jo vetëm studiues të përkushtuar, por edhe profesionistë të zotë.

Krahas zhvillimit të aftësive të veçanta në fusha të ndryshme të dijes, UNIKO, si promotor i formës më të lartë të arsimit, synon edhe përvetësimin e kompetencave specifike dhe saktësinë metodologjike: këto janë tiparet që e bëjnë një individ jo vetëm specialist kompetent, por dhe një qytetar të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë. Ky qëllim mbështetet nga bashkërendimi i metodave kërkimore me disiplina të shumta mësimore. Sfida për Universitetin tonë është kombinimi i sasisë me cilësinë për të arritur rezultatet e dëshiruara.

Për të vënë në jetë këto synime, pra për të nxjerrë jo vetëm individë të formësuar me dije bashkëkohore, por edhe profesionistë të kërkuar nga tregu i punës, ne do të mbështetemi në dy shtylla bosht: Edukimi dhe Kërkimi Shkencor.

Duke u mbështetur te natyra, orientimi dhe historia e UNIKO, besojmë se themelet e suksesit duhet të hidhen mbi truallin e dialogut, për t'u folur hapur si studentëve edhe shoqërisë.





PROCESI I PLANIFIKIMIT



Ky Plan Strategjik është zbatim konkret i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020) për politikat afatmesme dhe afatgjata në veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe ka marrë parasysh sugjerimet e stafit akademik dhe grupeve studentore të interesuara për zhvillimin e UNIKO, të shprehura në programet e zhvillimit të njësive kryesore të këtij institucioni. Qëllimi është të zbulohen rrugët e përmirësimit dhe idetë novatore për ta përgatitur Universitetin drejt sfidave të së ardhmes.

Duke studiuar masat e mara nga universitetet e tjera dhe/ose të përdorura edhe në UNIKO, ne kemi përcaktuar objektivat ku do të përqendrohemi dhe mekanizmat për arritjen më të mirë të tyre.

Në këtë plan strategjik janë marë parasysh planifikimet e bëra nga njësitë dhe fakultetet përkatëse, si dhe propozimet e dhëna nga Këshilli Studentor, me qëllim që të ndërtohet një hartë strategjike e mirëpeshuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 40 pika 3 (ku shkruhet se Rektori harton planin strategjik të zhvillimit të institucionit, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe kryesore të institucionit, si dhe ato të administratorëve”), neni 38, pika b (ku shkruhet se Senati Akademik propozon planin strategjik të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë), neni 49, pika b (ku shkruhet se Bordi i Administrimit, me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij).

Ky plan parashikon mekanizma dhe instrumente që janë në gjendje të sigurojnë koherencë të plotë të objektivave strategjike dhe veprimeve të nevojshme për të arritur nivelet e pritshme të rezultateve.

Hapat e ndërmarë në hartimin e Planit Strategjik 2016-2020

1. Përputhja e qëllimeve të këtij plani me misionin dhe vizionin e UNIKO, duke u ndalur kryesisht në përmirësimin e veprimtarive kryesore institucionale: të edukimit dhe kërkimit shkencor;
2. Analizimi i gjendjes së Universitetit dhe përpunimi i analizës SWOT mbi dritën e ndryshimeve dhe rezultateve të arritura nga objektivat strategjike të vendosur në planet e mëparshme afatshkurtër/afatgjatë të Universitetit
3. Përcaktimi i objektivave strategjike dhe atyre bazë, në përputhje me treguesit e dalë nga analiza e sipërpërmendur;
4. Përcaktimi i treguesve të veçantë të rezultateve sasiore, të lidhur me secilin objektiv bazë;
5. Diskutimi i hartës strategjike i hartuar në bashkëpunim me rektoratin, dekanatet dhe Këshillin studentor, për të bërë ndryshimet e mundshme;
6. Miratimi i draftit përfundimtar të Planit Strategjik të Zhvillimit të UNIKO 2016-2020.



MISIONI



MISIONI

Si një institucion publik i Arsimit të Lartë në Shqipëri, UNIKO synon të realizojë në mënyrë të vazhdueshme misionin e tij për arsimin e lartë si një e mirë dhe përgjegjësi publike, përmes këtyre objektivave:

- të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet;
- të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend;
- të ofrojë mundësi të barabarta për të përfutuar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës;
- të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare;
- të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit;
- të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor;
- të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.






VIZIONI



Universiteti ynë:

- një bashkësi studentësh, mësime dhe stafi administrativ dhe teknik, njeh rëndësinë e të gjithë anëtarëve të tij dhe shpërblen ata që punojnë për të ndjekur objektiva të përbashkëta në edukim dhe kërkim;
- vendi i krijimit, zhvillimit, përcjelljes dhe mbrojtjes së dijeve, u garanton studentëve dhe stafit mundësitë më të mira për studim dhe kërkim, për të shprehur talentet drejt qëllimeve ambicioze në fushën profesionale dhe arsimore, duke ofruar mundësi për të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- një institucion akademik publik, synon të përmirësojë mësime dhe punën kërkimore dhe transferimin e njohurive në të mirë të shoqërisë, në nivelin rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Në këtë këndvështrim, stafi dhe bashkëpunëtorët e kualifikuar do të lehtësojnë dialogun dhe bashkëpunimin me universitetet e tjera për të arritur rezultate cilësore;
 - një institucion i hapur ndaj dialogut të brendshëm dhe të jashtëm, ndjek qëllimet e tij në përputhje me vlerat e autonomisë, respektin për mendimin “ndryshe” dhe përgjegjësinë sociale.



ANALIZA E GJENDJES SË DERITANISHME



ANALIZA E GJENDJES SË DERITANISHME

Ky Plan strategjik është hartuar pas një analize të hollësishme SWOT, duke mbajtur parasysh faktorët e brendshëm (pikat e forta dhe të dobëta) si dhe faktorët e jashtëm (mundësitë dhe kërcënimet). Kjo analizë u përgatit në sajë të punës së njësive përbërëse të UNIKO, informacioneve të përditësuara të vëna në dispozicion nga sekretaritetë mësimore, personeli ndihmësmësimor dhe sektorët e administratës së UNIKO.

Për të përfunduar analizën dhe për të nxjerrë në pah elementet kryesore të fazës së hartimit të këtij plani, janë marë parasysh burimet e mëposhtme:

- Fushat strategjike të theksuara nga Rektori gjatë takimeve kryesore publike të mbajtura në fillimet e mandatit të tij;
- Programi afatmesëm për zhvillimin e Universitetit “Fan S. Noli” mbi bazën e strategjisë kombëtare të Arsimit të Lartë (2008-2013) dhe kushteve të rajonit të Korçës;
- Raporti i vlerësimit të brendshëm të sigurimit të cilësisë 2014-2015;
- Plani strategjik i hartuar nga dekanati i çdo fakulteti;
- Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”



- **Tradita dhe përvoja e gjatë e Universitetit** për një periudhe të gjatë (45vjet);
- **Rezultatet** ekzistuese të mësimdhënies **dhe përvoja** e mirë që ofrojnë elementet bazë të kërkuara për programet e konsoliduar të ciklit të parë dhe të dytë në hartimin dhe përmirësimin e programeve të reja e dinamike;
- **Mjedise dhe infrastrukturë bashkëkohore** për një zhvillim normal të punës mësimore dhe kërkimore-shkencore në Universitet. Infrastruktura në dispozicion të UNIKO është e mjaftueshme për të siguruar kushte të kënaqshme pune për studentët dhe pedagogët;
- **Programe bashkëkohore studimi** dhe Kurrikula të veçanta në përputhje me kërkesat e zhvillimit të Rajonit;
- **Staf me moshë relativisht të re**, entuziast dhe i gatshëm për të bërë përpjekje maksimale për kualifikim të vazhdueshëm, si përkushtimi i tyre për të krijuar një mjedis pune të ngrohtë dhe frymëzues për studentët;
- **Shkalla e lartë e kualifikimit të stafit** akademik të brendshëm të çdo fakulteti dhe atij mbështetës;
- **Lidhjet e ngushta të UNIKO** me Universitetet brenda dhe jashtë vendit.
- **Bashkëpunimi kombëtar e ndërkombëtar, pjesëmarrja në projekte dhe trajnime të ndryshme; Organizimi i mirë i praktikave profesionale** të studentëve në fushat e edukimit, të bujqësisë, ekonomisë, mjekësisë etj;
- **Përmirësim i ndjeshëm i fondit të bibliotekës** në fakultete me literaturë shqipe dhe të huaj si për pedagogët dhe për studentët. Rritja e interesit të studentëve në shfrytëzimin e literaturës dhe internetit në bibliotekë.
- **Dixhitalizimit të gjithë punës në UNIKO**, me synimin e përmirësimit të shërbimeve dhe informimit të studentëve;
- **Përmirësimi i rregulloreve të studimit** në përputhje me synimet afatmesme dhe afatgjata të institucionit për përgatitjen e specialistëve në fushat e studimit që ofron;
- **Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë.** Cilësia e veprimtarisë së UNIKO sigurohet nëpërmjet një sistemi të brendshëm, të përbërë nga strukturat organizative të UNIKO. Ngritja e sistemit të sigurimit të cilësisë të përbërë nga Grupet e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë në të gjitha nivelet (departament, fakultet dhe rektorat);
- **Përfshirja e studentëve në vendimmarrje.** Organizimi i studentëve nëpër Këshillat studentore, përfaqësimi i tyre në organet drejtuese (Senatin Akademik dhe Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë), përfshirja e studentëve në procesin e hartimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit;
- **Përvoja e fituar nga Qendrat e Ekselencës si njësi bazë kërkimore dhe trajnuese për formimin e vazhduar.**
- **Vendndodhja gjeografike e UNIKO** si qendër universitare për gjithë rajonin juglindor të Shqipërisë dhe në kufi me dy shtete ballkanike ofron mundësi për përthithjen e studentëve të rajonit dhe më gjerë, si dhe për shkëmbimi përvojash në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor.
- **Shkëmbim përvojash në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor.**

Pikat e forta

- Preferencë jo e lartë nga maturantët për disa programe studimi;
- Cilësia jo e lartë e studentëve në hyrje dhe në përfundim të studimeve;
- Mungesa e ciklit të tretë të studimeve (doktoratë) në disa fakultete;
- Mungesa e kriterëve kualifikuese për studentët në programet “Master”;
- Sigurimi i fondit të literaturës bazë të disa lëndëve dhe moduleve mësimore, me qëllim që të jetë e zbatueshme dhe të shfrytëzohet nga studentët në të gjitha programet;
- Mungesa e bibliotekave digjitale të Fakulteteve;
- Raporti numerik pedagog-student dhe pedagog i brendshëm-pedagog me kohë të pjesshme.
- Mungesa e një mjedisi të përshtatshëm sportiv;
- Mungesa e database të plotë për punësimin e studentëve të diplomuar në vite dhe gjallërimi i lidhjeve të vazhdueshme me ta.

Pikat e dobëta

Mundësitë

- Vendndodhja e UNIKO në pozicion gjeografik për rajonin juglindor të Shqipërisë dhe në kufi me dy shtete ballkanike ofron mundësi për përthithjen e studentëve të rajonit dhe më gjerë, si dhe për shkëmbimi përvojash në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor;
- Hapja e programeve të Ciklit III;
- Ngritja e qendrave Kërkimore shkencore;
- Mundësitë për rritjen e bashkëpunimit të Fakulteteve me institucionet publike dhe private;
- Kthimi i fakulteteve në qendra trajnimi për të gjithë specialitetet që ofrojnë;
- Mundësia e dhënies të mbështetjes financiare nga organizma qeveritare për studentet me rezultatet më të mira në fakultete;
- Përmirësimi dhe standardizimi i syllabuseve mbi bazë kompetencash.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i kualifikimit të stafit të pedagogëve;
- Promovimi më efektiv për thithjen e studentëve cilësorë;
- Bashkëpunimi midis institucioneve të arsimit të lartë në vend dhe jashtë tij, përbën një mundësi për shkëmbim përvoja, ekspertize, informacioni, dijesh, teknologjish dhe burimesh njerëzore, por, njëkohësisht, ai shërben edhe si një mundësi për reflektim e përmirësim të vazhdueshëm të veprimtarisë së UNIKO;
- Proceset integruese, projektet e përbashkëta në të cilat është përfshirë UNIKO, krijojnë mundësi të mëdha për zgjerimin e bashkëpunimit me institucione brenda e jashtë rajonit dhe më gjerë, në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor.

- Numri i ulët i studentëve që duan të frekuentojnë disa nga programet e studimit që ofron UNIKO;
- Niveli i ulët i maturantëve që preferojnë UNIKO;
- Kërkesa aktuale jo e lartë nga tregu i punës.
- Cilësia e ulët e kandidatëve-studentë në hyrje që vijnë nga shkollat e mesme profesionale
- Mungesa e veprimtarive të përbashkëta dypalëshe studentë-nxënës maturantë të shkollave të mesme për të parë mundësinë e përthithjes së tyre programet e studimit që ofron UNIKO;
- Ndryshimet e shpeshta të kuadrit ligjor ndikojnë negativisht në veprimtarinë e Institucioneve të Arsimit të Lartë, pasi përshtatja me ndryshimet e reja kërkon kohë dhe harxhim të energjive njerëzore dhe të drejtimit, ndikon në uljen e efektivitetit të veprimtarisë së përgjithshme të institucionit;
- Mungesa e një tregu të gjerë punësimi në nivel rajonal, mungesa e të dhënave mbi punësimet në nivel rajonal e më gjerë krijon vështirësi në orientimin e programeve të studimit dhe në përcaktimin e kuotave në çdo program.

Kërcënimet



OBJEKTIVAT



Edukimi

A.1 Përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit, rezultateve të të nxënit dhe profilet e të diplomuarve edhe në raport me nevojat e individëve dhe shoqërisë

A.2 Çelja dhe ristrukturimi i programeve të reja në përmbushje të kërkesave të tregut

A.3 Përmirësimi i kurrikulës me bazë rezultatet e të nxënit

A.4 Përmirësimi i shërbimeve në mbështetje të studentit për të rritur cilësinë e studimeve dhe jetës studentore

A.5 Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies duke përdorur metodologji të reja (p.sh. mësimi elektronik, të nxënit nëpërmjet TIK-ut) dhe nxitja e kualifikimit të stafit akademik në përmirësimin e aftësive pedagogjike.

Kërkimi

B.1 Mbështetja për kërkimin shkencor dhe nxitja e kërkimeve të aplikuara në shërbim të zhvillimit të individëve dhe shoqërisë.

B.2 Përmirësimi dhe rritja e rezultateve kërkimore në UNIKO

B.3 Përmirësimi dhe forcimi i marrëdhënieve të UNIKO me tregun e punës dhe shoqërinë.

B.4 Mbështetje institucionale për kualifikimin e stafit

A-B.1. Akreditimi dhe kontrolli i cilësisë

A-B.2. Menaxhimi dhe transparenca financiare



EDUKIMI



OLGER ZAČE
PHOTOGRAPH

Objektivi strategjik	Objektivi bazë	Treguesi
A.1 Përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit, rezultateve të të nxënit dhe profilet e të diplomuarve edhe në raport me nevojat e individëve dhe shoqërisë	A.1.1 Ristrukturimi i programeve të studimit sipas kërkesave të MAS mbi bazën e udhëzimeve dhe standardeve të kërkuara nga Ligji Nr. 80/2015	T.01 Riorganizimi i njësisive bazë. T.02 Riorganizimi i programeve të ciklit të parë, të dytë. T.03 Unifikimi i formateve të rregulloreve të programeve të studimit dhe i syllabuseve, për modulet e lëndëve përkatës në çdo program.
	A.1.2 Nxitja e frekuentimit të rregullt të studimeve për të siguruar vlerësim rigoroz	T.01 Numri i studentëve të pafrekuentuar në përfundim të vitit të parë T.02 Përqindja e të diplomuarve
	A.1.3 Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të kompetencave të fituara	T.01 Vlerësimi i studentëve të diplomuar T.02 Vënia në punë e kompetencave të fituara në programin përkatës të studimit
	A.1.4 Sigurimi i cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturës	T.01 Përqindja e studentëve të kënaqur me shërbimet e ofruara T.02 Përqindja e studentëve të regjistruar nga zona jashtë rajonit të Korçës T.03 Shfrytëzimi i EDE-s si qendër mbështetëse për realizimin e programeve Master/Doktoraturë, FB
A.1.4 Lidhja me tregun e punës	T.01 Zgjedhja që do të bëjnë studentët kandidatë për programe studimi të kërkuara T.02 Hapja e programeve të reja T.03 Përshtatshmëria e të diplomuarve me kërkesat e tregut T.04 Përmirësimi i praktikave mësimore (internship)	

Objektivi strategjik	Objektivi bazë	Treguesi
<p>A.2 Çelja dhe ristrukturimi i programeve të reja në përmbushje të kërkesave të tregut</p>	<p>A.2.1 Përgatitja e dokumentacionit të kërkuar</p>	<p>T.01 Percentage of first year drop-outs</p> <p>T.01 Plotësimi në kohë i kërkesave dhe standardeve të MAS</p>
	<p>A.2.2 Çelja e programeve 2-vjeçare të kualifikimit profesional, të cilat synojnë tërheqjen e kontingjenteve që kanë përfunduar shkollën e mesme, por nuk kanë mundur të fitojnë të drejtën e studimit në shkollën e lartë</p>	<p>T.01 Hapja e programit 2-vjeçar “Teknik veteriner”, FB</p> <p>T.02 Hapja e programit 2-vjeçar “Edukatorë për foshnjërinë e hershme”, FEF</p> <p>T.03 Hapja e programit 2-vjeçar “Hoteleri-Turizëm”, FE</p>
	<p>A.2.3 Çelja dhe përmirësimi i programeve të ciklit të dytë</p>	<p>T.01 Hapja e programit Master pranë Departamentit të Agronomisë, FB</p> <p>T.02 Përfundimi i procedurave për hapjen e programit Master Shkencor në “Menaxhim dhe transportim i gazit dhe naftës” në bashkëpunim me disa IAL</p> <p>T.03 Zbatimi i pikës 2, 3, 4 të nenit 83 të ligjit nr.80/2015, i cili parashikon kthimin e ciklit të dytë të studimeve master në dy vite akademike (120 kredite)</p> <p>T.04. Shmangia e formimit në profiling minor</p>
	<p>A.2.4 Çelja e programeve të ciklit të tretë</p>	<p>T.01 Hapja e programit doktoraturë “Gjuhësi e aplikuar dhe krahasuese”, FEF në bashkëpunim me Universitetin e St. Kliment, Sofje, Bullgari,</p>

Objektivi strategjik	Objektivi bazë	Treguesi
<p>A.3 Përmirësimi i kurrikulës me bazë rezultatet e të nxënit</p>	<p>A.3.1 Ristrukturimi i kurrikulave universitare me bazë kompetencat</p>	<p>T.01 Ndryshimet e evidentuara në hartimin e syllabuseve</p>
	<p>A.3.2 Zbatimi dhe vlerësimi i kompetencave që duhet ofrojë kurríkula në çdo program studimi, me ato që kërkohen nga tregu i punës</p>	<p>T.01 Hartimi i katalogut të kompetencave</p>
	<p>A.3.3 Përmirësimi i metodave të mësimdhënies</p>	<p>T.01 Përfshirja dhe vendosja e studentëve në qendër të mësimin</p>
	<p>A.3.4 Krijimi i një mjedisi frymëzues pune dhe mësimi, duke u përqendruar te mësimdhënia me në qendër studentin, si një mënyrë për të fuqizuar studentin në të gjitha format e edukimit, duke ofruar zgjidhjen më të mirë për rrugë të të mësuarit të qëndrueshëm dhe fleksibël.</p>	<p>T.01 Përqindja e studentëve të kënaqur me kurríkulën dhe metodat e mësimdhënies</p>
	<p>A.3.5 Analiza e kurrikulave</p>	<p>T.01 Vlerësimi i rezultateve të të nxënit T.02 Harta e arritjeve për të diplomuarit</p>

Objektivi strategjik	Objektivi bazë	Treguesi
----------------------	----------------	----------

A.4 Përmirësimi i shërbimeve në mbështetje të studentit për të rritur cilësinë e studimeve dhe jetës studentore

A.4.1 Përmirësimi i shërbimeve me qëllim që të garantohet rritja e cilësisë së studimeve dhe jetës studentore edhe nëpërmjet partneriteteve private dhe publike

T.01 Përforcimi i rolit të Qendrës së karrierës

T.02 Përforcimi i rolit të Këshillit studentor

T.03 Organizimi i veprimtarive artistike sportive me pjesëmarrjen e studentëve

T.04 Lidhja e marrëveshjeve me institucione artistike e sportive për shfrytëzimin e infrastrukturës

T.05. Angazhimi i studentëve në veprimtari shkencore

A.5 Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies duke përdorur metodologji të reja (p.sh. mësimi elektronik, të nxënit nëpërmjet TIK-ut) dhe nxitja e kualifikimit të stafit akademik në përmirësimin e aftësive pedagogjike.

A.5.1 Përmirësimi i njohurive të studentëve & zotërimi, rritja e të menduarit kritik, kalimi në metoda të reja të mësimdhënies larg formatit të ligjëratave të thjeshta, përparimi drejt një sistemi vlerësimi objektiv (p.sh. i bazuar në kompetencë, aktiv/të aplikuar etj.)

T.01 Përqindja e stafit akademik të trajnuar

T.02 Përqindja e stafit akademik që integron teknologjinë e re në procesin e mësimdhënies

T.03 Monitorimi i ecurisë së studentëve

T.04 Tërheqja e mendimit të studentëve mbi metodat e përdorura nga pedagogët

T.05 Stafi mësimdhënies përditëson njohuritë me zhvillimet më të fundit në metodat e të mësuarit dhe të nxënit



Kërkimi shkencor



Fusha strategjike | Kërkimi shkencor

Objektivi strategjik

B.1 Mbështetja e kërkimit shkencor dhe nxitja e kërkimeve të aplikuara në shërbim të zhvillimit të individëve dhe shoqërisë.

B.1.1 Përmirësimi i kërkimit për të trajtuar sfidat e mëdha sociale

T.01 Numri i stafit të përfshirë në projekte konkurruese në raport me numrin e përgjithshëm të personelit mësimdhënës

B.1.2 Nxitja dhe mbështetja e performancës konkurruese të kërkimit rajonal e kombëtar duke rritur cilësinë dhe ndikimin e tij.

T.01 Niveli i përfshirjes në projekte rajonale
T.02 Niveli i përfshirjes në projekte ndërkombëtare
T.03 Përmirësimi i cilësisë dhe produktit të Kërkimit Shkencor
T.04 Patentat e fituara

B.1.3 Përmirësimi i marrëdhënieve me jashtë, si dhe nxitja e mbështetjes dhe pjesëmarrjes në infrastrukturën e kërkimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

T.01 Zgjerimi i fushës së aplikimeve edhe në projekte në të cilat Universiteti të ketë rolin e koordinatorit.
T.02. Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme me stafin akademik për aplikime në projekte

B.1.4 Hapja e programeve të reja të ciklit të tretë dhe forcimi i programeve ekzistuese

T.01 Forcimi i programit të doktoraturës në Fakultetin e Bujqësisë
T.02 Në bashkëpunim me Universitetin “St. Klement Ohridski”, Sofies Bullgari, do të hapet programi i përbashkët i doktoraturës në Gjuhësi të aplikuara dhe krahasuese
T.03 Të punohet për hapjen e programeve të ciklit të tretë dhe në FSHNH dhe FE

B.1.5 Përmirësimi dhe rritja e cilësisë së meritës shkencore në rekrutimin e stafit dhe zhvillimin e karrierës.

T.01 Bursat për periudha të shkurta vizitash hulumtuese jashtë vendit.
T.02 Institucionalizimi i programeve të shkëmbimit dhe rritja e numrit të përfituesve.

Fusha strategjike | Kërkimi shkencor

Objektivi strategjik	Objektivi bazë	Treguesi
B.2 Përmirësimi dhe rritja e rezultateve kërkimore në UNIKO.	B.2.1 Hartimi i planit strategjik për Kërkimin Shkencor në UNIKO	T.01 Krijimi i grupit të punës për hartimin e planit. T.02 Identifikimi i fushave parësore të kërkimit sipas fakulteteve dhe njësive
		T.01 Identifikimi i kontakteve dhe bashkëpunëtorëve shkencorë mbështetës nga rajoni; T.02 Krijimi i bazës së të dhënave të kontakteve të bashkëpunëtorëve nga rajoni; T.03 Nxitja dhe promovimi i pozitës për profesorët e ftuar për ligjërime dhe kërkime në njësitë akademike që kanë në dispozicion kapacitete.
	B.2.2 Nxitja e përfshirjes së kapaciteteve të kualifikuara të rajonit në kërkimet shkencore/arte dhe aktivitetet zhvilluese	
	B.2.3 Rregullimi me statut i angazhimit të stafit në veprimtari kërkimore	T.01 Përcaktimi në statutin e ri të të drejtave dhe detyrimeve të stafit për angazhim në veprimtari kërkimore në përputhje me standardet evropiane.
	B.2.4 Rritja dhe ruajtja e integritetit akademik	T.01. Raportimi i rasteve të plagjiaturës T.02. Aplikimi i programeve softuerike për të shmangur plagjiaturën
B.2.5. Përmirësimi i infrastrukturës kërkimore	T.01. Shndërrimi i EDE në qendër kërkimore-shkencore si njësi bazë që kryen veprimtari kërkimore dhe zhvillimi. T.02. Akreditimi i laboratorit të agrokimisë nga AKA, për të kryesr analiza të certifikuara të tokës dhe bimëve T.03. Regjistrimi i pronave në emër të UNIKO në ZVRPP T.04. Shfrytëzimi i laboratorëve ekzistues duke përdorur programe të specializuara	

Fusha strategjike | Kërkimi

Objektivi strategjik	Objektivi bazë	Treguesi
	B.2.6 Përkrahja e inovacioneve dhe mbrojtja e pronës intelektuale	T.01 Rishikimi i Rregullores së etikës
		T.01 Zbatimi i projektit për digjitalizimin e bibliotekës.
		T.02 Vendosija e lidhjeve të bibliotekës me konsorciume të huaja.
		T.03 Nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe mes UNIKO dhe Bibliotekës Kombëtare apo Bibliotekës së Akademisë së Shkencave.
	B.2.7 Digjitalizimi i bibliotekës dhe ofrimi i e-shërbimeve.	
	B.2.8 Rritja e nivelit të botimeve universitare në raport me numrin e studentëve	T.01 Mbështetje financiare ose teknike për botimet e teksteve universitare. T.02 Numri i teksteve të botuara. T.03 Rishikimi i Rregullores së Këshillit Shkencor dhe botimeve
	B.2.9 Vendosija e lidhjeve strategjike të partneritetit me institucione të huaja	T.01 Rishikimi i bazës ligjore për bashkëpunime ndërkombëtare. T.02 Grupet kërkimore të çdo fakulteti identifikojnë partnerët strategjikë

Objektivi strategjik	Objektivi bazë	Treguesi
<p>B.3 Përmirësimi dhe forcimi i marrëdhënieve të UNIKO me tregun e punës dhe shoqërinë.</p>	<p>B.3.1 Studimi i tregut dhe zbatimi i tij në rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit</p>	<p>T.01 Përfundimi i procesit të studimit të tregut</p>
	<p>B.3.2 Promovimi i kompetencave akademike dhe profesionale për të gjithë të diplomuarit që synojnë punësim në sektorin publik dhe në jetën publike</p>	<p>T.01 Hartimi i hartës vlerësuese të studentëve dhe të diplomuarve për çdo program studimi</p>
	<p>B.3.3 Rritja e marrëdhënieve me shkollat e mesme</p>	<p>T.01 Sigurimi i informacioneve nga këto shkolla për kurrikulën dhe këshillimin e karrierës T.02 Organizimi i sesioneve promovuese</p>
	<p>B.2.7 Vendosja e lidhjeve strategjike të partneritetit me institucione të huaja</p>	<p>T.01 Rishikimi i bazës ligjore për bashkëpunime. T.02 Grupet kërkimore të çdo fakulteti identifikojnë partnerët strategjikë</p>

Objektivi strategjik	Objektivi bazë	Treguesi
B.4 Mbështetje institucionale për kualifikimin e stafit.	B.4.1 Nxitje e stafit për të realizuar në kohë marrjen e titujve dhe gradave shkencore.	T.01 Mbështetje financiare për të përballuar botimet e tezave të doktoraturës. T.02. Lehtësimi i rrugëve për marrjen e informacionit nëpërmjet Sektorit të Kërkimit dhe Projekteve për thirrjet e konferencave dhe botimeve. T.03. Rikrijimi i Këshillit të Profesorëve

Fusha strategjike | Edukimi-Kërkimi

Objektivi strategjik

Objektivi bazë

Treguesi

A.B.1. Akreditimi dhe kontrolli i cilësisë

A.B.1.1. Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies për t'ju afruar standardeve për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të AL-të

T.01 Numri i bashkëpunimeve me institucione vendase dhe të huaja

T.02 Përqindja e stafit të trajnuar nga NJSBC

T.01 Zgjerimi i sipërfaqeve të mësimdhënies për të arritur standardet evropiane.

T.02 Në Fakultetin e Shkencave do të ndërtohen 6 salla të reja leksionesh dhe mjedise të tjera.

T.03 Rritja e sipërfaqeve çlodhëse dhe ato të gjelbërimit përreth mjediseve të universitetit.

T.04 Brenda mjediseve të universitetit do të krijohen kushte lehtësuese për studentët (poste interneti etj.), duke shfrytëzuar hollet e ndërtesave

A.B.1.2. Përmirësimi i mjediseve fizike dhe virtuale të të nxënit për të nxitur të nxënit me studentin në qendër.

T.05 Një librari e madhe universitare për studentët, ku tekstet dhe materialet e printuara do të jenë me çmime të reduktuara të përfshira në Kartën e Studentit

Fusha strategjike | Edukimi-Kërkimi

Objektivi strategjik

Objektivi bazë

Treguesi

A.B.1. Akreditimi dhe kontrolli i cilësisë

A.B.1.3. Shërbimet mbështetëse këshilluese në lidhje me mjedisin e të nxënit me studentin në qendër.

A.B.1.4. Nxitja për rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve për stafin mësimdhënës.

T.01 Hartimi i udhëzimeve dhe trajnimeve lehtësuese

T.02 Përmirësimi i punës së sektorit të studimeve dhe Karrierës studentore

T.03 - Qasja e studentëve me nevoja të veçanta në të gjitha ndërtesat;

- Qasja e studentëve me nevoja të veçanta në të gjitha programet e studimeve;

- Pajisjet për studentët me nevoja të veçanta;

- Përfshirja e studentëve me nevoja të veçanta në zhvillimin e karrierës së tyre etj.

T.01 Proces transparent i punësimit të stafit mësimdhënës.

T.02 Promovimi dhe stimulimi i stafit të ri

T.04 Staf i mësimdhënës shpërblehet.

T.04 Shpenzimet për mbrojtjen e doktoraturave përballohen nga buxheti UNIKO

A.B.1. Akreditimi dhe kontrolli i cilësisë

A.B.1.5. Krijimi i lidhjeve të forta mes stafit dhe studentëve

T.01 Tërheqja e maturantëve kandidatë më cilësorë për të vazhduar studimet në UNIKO

T.02 Shkalla e cilësisë së të diplomuarve dhe e studentëve të viteve të ndërmjetme.

T.03 Raporti staf/student;

T.04. Vlerësimi i studentëve në lidhje me marrëdhëniet e tyre me stafin.

T.05. Rishikimi dhe përmirësimi i kurrikulave dhe programeve të studimit

A.B.1.6. Zhvillimi i mekanizmave për cilësinë e mësimdhënies (sesionet e organizuara, numri i të trajnuarve, etj.)

T.01 Realizimi i anketimit me studentë (në internet), punëdhënësit dhe të diplomuarit (alumni) në mënyrë që të merren reagime në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies

T.02 Organizimi i tryezave të rrumbullakëta në departamente për shkëmbimin e informacioneve shkencore

A.B.1.7. Matja e rezultateve të të nxënit

T.01 Katalogu i kompetencave

T.02 Strategjitë për vlerësimin e të nxënit të studentëve janë të larmishme

T.03 Shpallja në kohë e rezultateve të vlerësimit

T.04 Sistemet e monitorimit të rezultateve të të nxënit janë në funksion të vazhdueshëm

T.05 Vjelja e mendimit të studentëve mbi drejtësinë dhe paanësinë e procesit të vlerësimit

Objektivi strategjik	Objektivi bazë	Treguesi
<p>A.B.1. Akreditimi dhe kontrolli i cilësisë</p>	<p>A.B.1.8. Përfshirja e studentëve në sigurimin e cilësisë</p>	<p>T.01 Përfaqësimi i studentëve në të gjitha proceset për sigurimi e cilësisë</p> <p>T.02 Raportime formale nga studentët rreth përfaqësimit në të gjitha aktivitetet për sigurimin e cilësisë.</p> <p>T.03 – NJSBC përcakton procedurat e sigurimit të cilësisë së bashku me studentët</p> <p>T.04. Krijimi i një sistemi për pranimin e reagimeve /raportimit të studentëve në lidhje me programet e studimit dhe shërbimet.</p> <p>T.05. Promovimi i studentëve si ekspertë të të mësuarit</p>
	<p>A.B.1. 9. Përshtatja e programeve të studimit me nevojat e tregut të punës</p>	<p>T.01 Përfundimi i studimit të tregut të punës</p> <p>T.02 Funkzionimi i mirë i grupeve të punës për çdo fakultet që do të marrë pjesë në studimin e tregut.</p> <p>T.03 Evidentimi i fushave më të kërkuara nga tregu.</p> <p>T.04 Hapja e programeve të reja të studimit.</p>

Objektivi strategjik	Objektivi bazë	Treguesi
<p>A.B.1. Akreditimi dhe kontrolli i cilësisë</p>	<p>A.B.1.10. Riorganizimi i strukturave drejtuese të çdo njësie</p>	<p>T.01 Organigrama e re e Rektoratit</p> <p>T.02 Organigrama e re e Fakulteteve</p> <p>T.03 Organigrama e re e Departamenteve</p>
	<p>A.B.1.11. Rritja e cilësisë së jetës shoqërore dhe artistike të studentëve</p>	<p>T.01 Stimulimi i studentëve cilësorë</p> <p>T.02 Organizimi i shfaqjeve artistike dhe spartakiadave</p> <p>T.03 Mbështetja e studentëve për të nxjerrë një organ të tyre periodik, si një tribunë të mendimit të lirë, si dhe përkrahjen e talenteve në fusha të ndryshme.</p> <p>T.04. Krijimi i një hapësire të veçantë në faqen elektronike të UNIKO për veprimtaritë e studentëve.</p> <p>T.05. Mbështetja financiarisht e studentëve që vijnë nga shtresa në nevojë.</p> <p>T.06. Stimulimi i studentëve me prirje të veçanta.</p>

Fusha strategjike | Edukimi-Kërkimi

Objektivi strategjik	Objektivi bazë	Treguesi
A.B.2. Menaxhimi dhe transparenca financiare	A.B.2.1 Ngritja e strukturave të administrimit financiar	<p>T.01. Bordi i Administrimit</p> <p>T.02. Grupi i Menaxhimit Strategjik</p> <p>T.03. Administratori i UNIKO</p>
		<p>T.01. Përcaktimi i prioriteteve</p> <p>T.02. Llogaritja e kostove për financim në edukim dhe kërkim shkencor.</p> <p>T.03. Parashikimi i të ardhurave të gjeneruara nga Kërkimi Shkencor</p> <p>T.04. Krahasimet me vitin paraardhës</p> <p>T.05. Thithja e financimeve private, nga bashkitë ARZH</p>
	A.B.2.2 Buxhetimi	T.06. Ruajtja e bilancit financiar.
	A.B.2.3 Kontrolli ekonomik-financiar	<p>T.01. Auditimi i brendshëm dhe i jashtëm</p> <p>T. 02. Sigurimi i transparencës ekonomik-financiare me pjesëmarrje dhe publikim online.</p>
A.B.2.4 Investimet kapitale		<p>T.01. Ndërtimi i një kompleksi sportive/kulturor (pas shpronësimit të truallit me marrëveshje me pushtetin vendor)</p> <p>T. 02. Zhvillimi i FSHNH me një shtesë godine për të lehtësuar procesin mësimesor - kërkimesor.</p> <p>T. 03. Ndërtimi i Qendrës Studentore</p>